

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

Mbikqyrja e punimeve per objektin: Ndërtim Rrugët Blloku 1, Lagjje Lurë Laknas

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT **FPP**): **71521000-6 -
Shërbime per mbikqyrje te ndertimit**

VLERA E FONDIT LIMIT: **2,607,334.79 (dy milion e gjashtëqind e shtatë mijë e treqind e tridhjetë e katër pikë e shtatëdhjetë e nëntë) lekë pa tvsh**

Detyrimi i përzgjedhjes së mbikëqyrësit është përcaktuar në :

- nenin 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, cituar “*Për të gjitha llojet e objekteve duhet të vendoset detyrimisht mbikëqyrësi/grupi i mbikëqyrësve të punimeve*”.
- Nenin 1, të vendimittë Këshillit të Ministrave nr. 610, datë 22.9.2022 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve”, cituar “*Mbikqyrja e punimeve bëhet për të gjitha llojet e objekteve të ndërtimit dhe kryhet ngambikëqyrës/grupi i mbikëqyrësve të punimeve, i cili ka përgjegjësi kontrollin e mbarëvajtjes të të gjithë procesit të zbatimit të punimeve, në përputhje me projektin, rregullat dhe standardet teknike të projektimit, zbatimit, si dhe destinacionin e objektit, duke pasur parasysh edhe anënekonomike të tij*”.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Kamez** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Mbikqyrja e punimeve per objektin: Ndërtim Rrugët Blloku 1, Lagjje Lurë Laknas

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 "Kriteret detyruese për skualifikim" Nenin 82 "Formulari përmbledhës i vetdeklarimit" dhe Neni 83 "Sigurimi i ofertes", të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe në mbështetje të Nenit 26 "Formulari përmbledhës i vetdeklarimit" dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP "1. *Bashkë me dorezimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik*".

Neni 83 i LPP "Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetdeklarimit të operatorit ekonomik sipas Shtojcës 10.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2022, 2023 dhe 2024** ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" "Ne lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë që operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të

tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet,

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

1. Për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratën e nënshkruar me entin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Enti Publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit të kontratës.
1. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77”Kërkesat për kualifikim”, të Ligjit Nr 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” pika 4..”ne lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zoterojnë burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të pershtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në vecanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të pershtatshme nga kontrata e zbatuara në të shkuarën” dhe nenit 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për kontratën e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20 % të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës”.*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë vlerën e fondit limit të shërbimit të kërkuar objekt procedure prokurimi, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë realizuar kontratën të ngjashme, të jetë afër limitit maksimal të lejuar dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues

mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të jenë të licensuar për kryerjen e shërbimeve objekt i kësaj kontrate. Ato duhet të disponojnë pikat e mëposhtme të licensës për mbikëqyrje punimesh:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:

N.P – 1	Punime gjurmimi në tokë
N.P - 4	Rruge, autostrada, ura

Përpunimet special të ndërtimit:

N.S – 1	Punime për prishjen e ndërtimeve
N.S – 18	Punime Topogjeodezike

Për operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe VKM nr. 759, datë 12.11.2014 “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, i ndryshuar, ku parashikohet se:

“Çdo individ apo person juridik, që kërkon të ushtrojë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe të mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim duhet të pajiset me licencën profesionale përkatëse dhe të regjistrohet në regjistrat profesionale të subjekteve të licencuara në këto fusha, bazuar në rregulloren bashkëlidhur këtij vendimi”.

Licensat si më sipër, janë vendosur duke pasur parasysh natyrën e punimeve të kontratës bazë, të parashikura në projekt-preventivat e dërguara nga strukturat përkatëse, përgjegjëse për zbatimin e tyre.

2.3.3 Dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik:

- a) Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojnë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë :
- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi Profil transport/rruge ura
 - 1 (një) Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshaider

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- Kontratë pune
- Diplomën universitare.
- Cv
- Libreze pune
- Licence individuale

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Të gjithë punonjësit e kërkuar sipas pikës 2.2.3/a, duhet të jenë në listpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit

2.3.4 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë Një punësim mesatar të paktën **8**(tete) personave, për 3 muajt e fundit të siguruar vertetuar me:

- Listpagesat per Periudhen e kerkuar

Argumentimi : Kërkesa e shkronjës a), të pikës 2.2.4, të kriterëve të veçanta për kualifikim është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4/b) dhe c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)” në ligjin e që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm dhe stafin e mjaftueshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës

2.2.5 Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se e zhvillojnë aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë dhe të shëndetit e sigurtisë në punë. Për këtë duhet të paraqesin certifikatat e mëposhtme :

- Certifikatë **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim;
- Certifikatë **ISO 45001:2018** mbi “Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurtisë në punë” lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim.

Certifikatat si më sipër duhet të paraqiten origjinale ose kopje të noterizuara, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

Argumentimi : Ky kriter është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se plotësojnë standartet e kërkuara të cilësisë dhe standartet për shëndetin dhe sigurinë në punë.

2.3.6 Operatoret ekonomike duhet të kenë paisjet dhe automjetet si me poshtë:

- *Gps 1 cope*
- *Total station 1 cope*

a) Per pajisjet operatori ekonomik duhet të paraqesi dokumentat që vertetojnë pronesinë e tyre, apo marrjen me qira të tij si psh: Fature tatimore të shitblerjes ose kontrate qiraje të noterizuar.

b) Per mjete që shenohen në regjistrat publike (automjetet) duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit/ certifikate pronesie, siguracionin e mjetit, certifikaten e kontrollit teknik, , leje qarkullimi.

c) Per mjetet e siguruar me qira, dokumentat e mesiperme duhet të shoqerohen edhe me kontratën perkatese noteiale të qirase/leasing/huapërdorjes e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.

Shënim: Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetedeklarimit sipas shtojcës 12 në DST.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose të kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi : Ky kriter është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se plotësojnë dhe kanë në dispozicion mjetet dhe paisjet e nevojshme për të realizuar shërbimin. Gps dhe total station duhet të përdoren për të kontrolluar matjet topografike dhe punën në terren, pasi vepra duhet të ndërtohet duke repektuar kuotat e dhëna nga projektuesi në projekt.

2.2.7 Për llogaritjen e çmimit të ofertës së tyre, Operatorët Ekonomikë duhet të kenë parasysh sa më poshtë:

- 1. Oferta ekonomike duhet të jetë në përputhje me VKM nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”.**

2. Të gjitha ofertat që do të jenë më të ulëta se vlerat minimale të lejuara në bazë të parashikimeve të VKM nr. 354, datë 11.05.2016, do të refuzohen.
3. Zërat e punimeve të parashikuara, janë sipas preventivit të punimeve, bashkëlidhur DT-ve.
4. Tarifat për drejtim punimesh dhe kolaudim janë llogaritur sipas VKM nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar nënenin 7/1, të VKM nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”, ku parashikohet se: *“Tarifat për shërbimet duhet të jetë një vlerë ndërmjet tarifave minimale dhe maksimale, të përcaktuara në këtë manual, në përputhje me ligjin e prokurimit publik”*.

Lidhur me parashikimet e përcaktuara në pikën 2.16. të DT “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera”, Nj.P. vlerëson se për sa i përket detyrave të stafit inxhinierik (drejtues teknik) të kërkuar respektivisht sipas pikës 2.2.3/a, të kriterëve të veçanta të kualifikimit, të shtojcës 7, të DT, ofertuesve nuk u lejohet të mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera, pasi nga autoriteti kontraktor ky staf inxhinierik (drejtuesit teknik) vlerësohet si përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të ndryshme të objektit që do të ndërtohet si dhe duhet të jenë pjesë e përvojës së ofertuesit, për të krijuar bindjen te AK se ofertuesit kanë aftësinë për të zbatuar kontratën sipas standardeve të kërkuara në përputhje me rëndësinë dhe destinacionin e përdorimit të objektit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.